



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.



**KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.
("KEK")**

Bazuar ne Nenin 20.4 dhe 22.1 te Ligjit nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike (LNP), Politikës së Kompensimit për Stafin Menaxhues, respektivisht Politikës mbi Kompensimin për Stimulimin e efektshmërisë në bazë te performancës për Zyrtares¹ e KEK-it, Komisioni i Auditimit propozon Bordit të Drejtorëve te KEK-ut t këtë:

DEKLARATE PËR POLITIKËN E KOMPENSIMIT PËR ZYRTARET E KEK- ut PËR VITIN 2018

1. Bazuar ne nenin 22 te Ligjit pet Ndërmarrjet Publike, Zyrtareve te KEK-it do t'u paguhet një kompensim themelor mujor i cili iu përmbahet konkurrencës dhe meritës, si dhe për kohën e shpenzuar ne mbledhjet e Bordit.
2. Zyrtarëve të lartë të KEK -ut iu takon kompensimi stimulues sipas kësaj Deklarate, në pajtim me pikën 4 të nenit 20 të LNP si dhe të përcaktuar në kontratën e tyre të punës në fuqi janë:
 - I. Drejtori Menaxhues (DM)
 - II. Drejtori Ekzekutiv Financiar) (DF)
 - III. Këshilltar i përgjithshëm/Sekretar i Kompanisë:

Për hir te qartësisë, në këtë liste nuk është përfshirë Zyrtari i Auditimit te Brendshëm (ZAB) pasi që këtë e drejte e realizon në Bazë të politikave Standarde të Operimit të Komisionit të Auditimit dhe ZAB.
3. Mënyra e vlerësimit te performancës dhe pagesës për kompensim stimulues për Zyrtarët të lartë të KEK-ut përcaktohet në raport me realizimin e objektivave të përfshirë në Planin Afarist dhe detyrave tjera të veçanta, specifike për secilin zyrtar të lartë të KEK-ut.
4. Me përjashtim të Zyrtari për Auditim te Brendshëm, kompensimi i efektshmërisë vlerësohet në periudhë vjetore dhe ky kompensim nuk mund te jete me i larte se përqindja 21 (%) nga kompensimi baze vjetor. Ky kompensimi i efektshmërisë do përcaktohet me vendim të veçantë të Bordit të Drejtorëve. .
5. Kompensim për Zyrtares nënkupton vlerën bruto si bazë tatimore për pagesën e tatimit në të ardhura personale.
6. Ngjashëm, sa i përket pagesës stimuluese vjetore, Komisioni i Auditimit do t'i shqyrtojë dhe caktojë ato brenda 30 ditësh kalendarike pas marrjes te Raportit te Auditorit te Jashtëm për Pasqyrat Financiare pas çdo ne fund viti, nëse çdo pagesë që u takon bazohet në kriteret e

¹ Sipas terminologjisë qe përdoret ne Kreun IV te Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligji 03/L-087,

përshkruara më sipër. Nëse pagesat u takojnë, atëherë ato do të përfshihen në pagesën e ardhshme, të rregullt, mujore të anëtarëve të Zyrtarëve.

7. Për hir të qartësisë dhe në pajtim me vendimin e Bordit të Drejtoreve , në rast se një zyrtar shkarkohet ose largohet nga pozita e tij/saj, ai/ajo nuk do të kenë të drejtën e pagesave stimuluese vjetore sipas përpjesëtimit, bazuar në atë se kur ka skaduar afati i tij/saj.
8. Të gjitha pagesat stimuluese do të zbriten sipas tatimit në të ardhura, sipas ligjit në fuqi.
9. Pjese integrale e kësaj deklarate do të jenë propozimi-Vlerësimi i performancës për:
 - Drejtorin Menaxhues (Shtojca 1)
 - Drejtorin Ekzekutiv Financiar (Shtojca 2)
 - Këshilltar i përgjithshëm/Sekretar i Kompanisë (Shtojca 3)
10. Kjo Deklarate për Zyrtaret e Kompanisë do të jete në fuqi nga për vitin kalendarik 2018.
11. Kjo Deklaratë hyn në fuqi në ditën e miratuar nga Bordi i Drejtoreve

Komisioni i Auditimit,
Fllanza Hoxha , Kryesuese

